

INSTRUMENTI HORIZONTAL PËR BALLKANIN PERËNDIMOR DHE TURQINË

*MEKANIZMI I KOORDINIMIT
TË EKSPERTIZËS*



Forcimi i drejtësisë

**Lufta kundër korrupsionit, krimit ekonomik
dhe pastrimit të parave**

**Promovimi i antidiskriminimit dhe mbrojtjes
së të drejtave të grupeve të cenushme**

Promovimi dhe mbrojtja e lirisë së shprehjes dhe e medias

Mekanizmi i Koordinimit të Ekspertizës

Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



BASHKIMI EVROPIAN

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës

Instrumenti Horizontal është një iniciativë bashkëpunimi e Bashkimit Evropian dhe e Këshillit të Evropës që synon të ndihmojë Përfituesit në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë për të përmbushur axhendat e tyre të reformave në përputhje me standardet evropiane, në fushën e të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit dhe demokracisë, që përbën gjithashtu një prioritet në procesin e zgjerimit të BE-së.

Programi, në zbatim që prej vitit 2016, bazohet në rezultatet tashmë të arritura në fushat kryesore: forcimi i drejtësisë; lufta kundër korrupsionit, krimit ekonomik dhe pastrimit të parave; promovimi i antidiskriminimit dhe mbrojtja e të drejtave të grupeve të cenueshme (përfshirë LGBTI, pakicat dhe romët) dhe promovimi dhe mbrojtja e lirisë së shprehjes dhe e medias.

Instrumenti Horizontal mbështet Përfituesit e tij nëpërmjet një qasjeje plotësuese të dyfishtë:

- ▶ Bashkëpunimit teknik të përshtatur, për një pajtueshmëri më të madhe me standardet evropiane, dhe
- ▶ Këshillimit dhe ekspertizës së posaçme si përgjigje ndaj kërkesave për analiza legjislative dhe asistencë lidhur me to, përmes Mekanizmit të Koordinimit të Ekspertizës (MKE).



ÇFARË ËSHTË MEKANIZMI I KOORDINIMIT TË EKSPERTIZËS ?

Mekanizmi i Koordinimit të Ekspertizës (MKE) është një mjet për ofrimin nga Këshilli i Evropës të ekspertizës legjislative dhe këshillimit në nivel politikash në përgjigje të kërkesave specifike. Ky mjet është pjesë e programit Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë (Instrumenti Horizontal).

CILI ËSHTË QËLLIMI I MKE-SË?

Objekti i punës së këtij mekanizmi përfshin ofrimin e këshillimit nga ekspertët për çështje ligjore dhe ato të politikave, duke përfshirë edhe vlerësimin e harmonizimit të legjislacionit dhe dokumenteve të politikave me standardet e Këshillit të Evropës në këto fusha:

- ▶ forcimi i drejtësisë;
- ▶ lufta kundër korrupsionit, krimit ekonomik dhe pastrimit të parave;
- ▶ antidiskriminimi dhe mbrojtja e të drejtave të grupeve të cenueshme;
- ▶ liria e shprehjes dhe e medias;
- ▶ çështjet kushtetuese që i përkasin fushës së kompetencës së Komisionit Evropian për Demokraci përmes Ligjit (i njohur më mirë si Komisioni i Venecias).

KUSH MUND TË BËJË KËRKESË NË KUADËR TË MKE-SË?

■ Anëtarët e qeverisë, kryetarët e parlamentit, kryetarët e komisioneve parlamentare, institucionet e Avokatit të Popullit ose institucionet e pavarura shtetërore të Përfituesit në fjalë mund të bëjnë kërkesë për një opinion eksperti sipas MKE-së.

■ Për më tepër, veçanërisht për çështjet që bien në fushën e kompetencës së Komisionit të Venecias, kërkesë për asistencë në kuadër të MKE-së mund të paraqitet gjithashtu nga Bashkimi Evropian dhe organet e Këshillit të Evropës (p.sh. Sekretari i Përgjithshëm, Komiteti i Ministrave, Asambleja Parlamentare dhe Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale). Ndërkohë, kërkesat për përmbledhje *amicus curiae* nga Komisioni i Venecias mund të bëhen edhe nga gjykatat kushtetuese të Përfituesve përkatës.

SI FORMULOHET KËRKESA DHE SI TRAJTOHET AJO?

■ Kërkesat për ekspertizë mund t'i drejtohet me shkrim me postë ose me faks Sekretares së Përgjithshme të Këshillit të Evropës. Kërkesat për ekspertizë të Komisionit të Venecias mund t'i drejtohen në mënyrë të drejtpërdrejtë Presidentit të Komisionit të Venecias.

■ Kërkesa duhet të jetë sa më e hollësishme, duke përfshirë emrin dhe llojin e legjislacionit apo të dokumentit të politikave mbi të cilin kërkohet ekspertizë, shkaku i kërkesës për ekspertizë apo për ndryshimin e legjislacionit apo të politikave objekt i kërkesës, si dhe afati kohor i parashikuar për miratimin e legjislacionit të ri apo të dokumentit të politikave (ose ndryshimet në legjislacionin ekzistues apo në dokumentet ekzistuese të politikave) pas dhënies së ekspertizës së kërkuar.

■ Me marrjen e kërkesave, ato trajtohen nga njësitë përkatëse të Këshillit të Evropës. Ndonëse Këshilli i Evropës synon që ta ofrojë ekspertizën e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, afati i saktë kohor përcaktohet përmes konsultimeve me autoritetet kërkuese.





CILAT JANË KRITERET PËR PRANIMIN E NJË KËRKESË?

- Një kërkesë e MKE-së duhet të përmbushë të gjitha kriteret e mëposhtme:
 - ▶ duhet të bëhet nga institucionet e listuara në seksionin e mëparshëm;
 - ▶ duhet të jetë objekt i ekspertizës së Këshillit të Evropës;
 - ▶ duhet të jetë brenda këtyre fushave tematike: forcimi i drejtësisë; lufta kundër krimit ekonomik; antidiskriminimi dhe mbrojtja e të drejtave të grupeve të cenueshme; liria e shprehjes dhe liria e medias. Kërkesa mund të jetë edhe brenda sferës së kompetencave të Komisionit të Venecias;
 - ▶ nuk mundësohet në kuadër të një prej projekteve ne vazhdim të programit Instrumenti Horizontal.

KU DUHET TË DREJTOHET KËRKESA?

- Kërkesat nën MKE mund të dërgohen me postë ose me faks në adresë të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës:
 - ▶ Secretary General of the Council of Europe
Council of Europe
F-67075 Strasbourg Cedex, France – Fax: + 33 3 88 41 27 99
Faqe interneti: www.coe.int/en/web/secretary-general/private-office
- Kërkesat nën MKE që kanë të bëjnë me ekspertizë të Komisionit të Venecias, mund t'i dërgohen me postë, e-mail ose me faks edhe Presidentit të Komisionit të Venecias:
 - ▶ President of the Venice Commission
Council of Europe
67075 Strasbourg Cedex, France – Fax: +33 3 88 41 37 38
e-mail: venice@coe.int

Shembuj të mbështetjes së ofruar në kuadër të MKE-së dhe rezultatet e arritura

- ▶ Në përputhje me **Opinionin** e Komisionit të Venecias mbi projektligjin për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë dhe sipas kërkesave të Nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Kuvendi i **Shqipërisë** miratoi ligjin e sipërpërmendur në prill 2020, duke adresuar në mënyrë efektive një sërë problemesh të mbetura lidhur me të drejtat e pronës mbi tokën bujqësore dhe çështjet e regjistrimit.
- ▶ Në një **Opinion** lidhur me projektligjin për ndryshimet në Ligjin për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe atë Prokurorial në **Bosnje dhe Hercegovinë**, Komisioni i Venecias bëri disa rekomandime për autoritetet në lidhje me dispozitat e reja dhe u kërkoi atyre që dispozitat e projektligjit të ishin më të sakta.
- ▶ Ministri i Drejtësisë kishte kërkuar një **Opinion** mbi projekt-ndryshimet e rishikuara të Ligjit për Këshillin Prokurorial të **Kosovës**. Vendimi vijues i Komisionit të Venecias theksonte se ndryshimet e rishikuara përfaqësonin një progres të qartë dhe domethënës krahasuar me projekt-ndryshimet fillestare. Si rezultat, Ligji nr. 08/L-136 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës u miratua më 14 prill 2022.
- ▶ Duke ndjekur rekomandimet e dala nga opinionin Urgjent i Komisionit të Venecias për projekt-ndryshimet në Ligjin për Këshillin Gjyqësor dhe Gjyqtarët, Ministri i Drejtësisë i **Malit të Zi** kërkoi një **Opinion** vijues mbi projekt-ndryshimet e rishikuara në Ligjin për Këshillin Gjyqësor dhe Gjyqtarët. Ekspertiza pasuese konfirmoi vlerësimin e përgjithshëm pozitiv të projektligjit dhe mirëpriti ndryshimet e reja të paraqitura.
- ▶ Në **Maqedoninë e Veriut**, Komisioni i Venecias mundësoi një **Opinion** mbi Projektligjin për Gjendjen e Jashtëzakonshme, duke theksuar se projektligji plotëson shumicën e kërkesave kryesore të përcaktuara nga Komisioni i Venecias në opinionet dhe raportet e tij të mëhershme. Opinioni mirëpriti gjithashtu draftin i cili propozonte një barazpeshë të arsyeshme të pushteteteve në rastin e gjendjes së jashtëzakonshme dhe parashikonte masa mbrojtëse që kufizojnë kompetencat e jashtëzakonshme të Qeverisë, duke plotësuar kështu boshllëqet e parregulluara në Kushtetutë.
- ▶ **Ekspertiza ligjore** mbi projektligjin për barazinë gjinore në **Serbi** u sigurua nga Divizioni i Këshillit të Evropës për Barazi Gjinore. Pas rishikimit të projektligjit, u ofrua ekspertizë ligjore vijuese duke vlerësuar shkallën në të cilën rekomandimet e mëparshme ishin marrë parasysh në draftin e rishikuar, por edhe duke analizuar dispozitat e reja bazuar në standardet e Këshillit të Evropës për barazinë gjinore dhe legjislationet model. Ligji për Barazinë Gjinore në Serbi, i cili është ligji i parë që trajton barazinë gjinore në Serbi në mënyrë sistematike, hyri në fuqi më 1 qershor 2021 duke përfshirë një pjesë të rekomandimeve të dhëna nga Këshilli i Evropës.

Kontakto

Ekipi i Koordinimit të Instrumentit Horizontal
Drejtoria e Koordinimit të Programit
Këshilli i Evropës
Avenue de l'Europe F-67075 Strasbourg Cedex, France
Tel. +33 (0)3 88 41 20 00
E-mail: Horizontal.Facility@coe.int



Programi i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë" (Instrumenti Horizontal III) është një iniciativë bashkëpunimi, që zgjat nga viti 2023 deri në vitin 2026.

Programi mbulon projektet në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë*, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Turqi.

Ai u mundëson përfituesve të përmbushin axhendat e tyre të reformave në fushat e të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit dhe demokracisë dhe të jenë në përputhje me standardet evropiane, që është gjithashtu një prioritet për procesin e zgjerimit të BE-së.

**Ky përcaktim është pa paragjykim për qëndrimet mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.*

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të bëjnë së bashku dijen, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë stabiliteti, demokracie dhe zhvillimi të qëndrueshëm, duke ruajtur diversitetin kulturor, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i përkushtuar të ndajë arritjet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të tij.

www.europa.eu

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e të drejtave të njeriut në kontinent. Në të bëjnë pjesë 46 shtete anëtare, përfshirë të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Te gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

www.coe.int

Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



BASHKIMI EVROPIAN

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës